



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Qyeterimi i gjuhës B (1)

Ngarkesa: 20 Seminare, 20 Leksione, 4 Kredite
Viti / Semestri : Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në rishprehjen në gjuhë të huaj të të gjitha të dhënave dhe materialeve me karakter historik mbi historinë e Qytetërimit turk, ku aktiviteti i tij mendor në përpunimin e mendimit kritik në rrethanat historike dhe në zhvillimin e civilizimit zë vendin kryesor. Shkathtësimi i të menduarit dhe të shprehurit në gjuhën e huaj mbi një bosht të përcaktuar ideor, formëson studentin në mbajtjen e një rendi logjik në ligjërimin e tij dhe në racionalitetin e përdorimit sa më të saktë të gjuhës greke. Përtej sa më sipër, studenti informohet me elementet e historisë së civilizimit përmes së cilave ka kaluar Turqia dhe se çfarë rezultatesh sollën këto elemente në popullin turk, në vendet fqinje e më gjerë. Kjo lëndë synon t'u japë studentëve njohuri historike mbi zhvillimet në shekullin 14-të dhe 16-të në Perandorinë Osmane.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte fillestare të historisë së qytetërimit turk.
2. Aftësi për të komunikuar në situata të ndryshme jo shumë të vështira.
3. Njohuri mbi fakte historike.
4. Aftësi për të treguar për gjëra mjaft të vështira nga ana gjuhësore.

Rezultatet e pritshme:

1. Përvetësojë dhe rishprehë në gjuhë të huaj (turke) njohuritë themelore mbi historinë e qytetërimit turk, duke ndërtuar ligjërim të qartë dhe të strukturuar mbi baza historike.
2. Shfaqë aftësi për të interpretuar dhe analizuar mendërisht ngjarje dhe fakte historike, duke zhvilluar mendim kritik në lidhje me periudhat kryesore të qytetërimit osman (shek. XIV–XVI).
3. Komunikojë në mënyrë funksionale dhe bashkëpunuese, si në punë individuale ashtu edhe në grup, duke përdorur me saktësi gjuhën për të trajtuar tema me përmbajtje historike.